

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO FONDIT KOSOVES PER EFICIENCEN TE ENERGJISE KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EF. KASNOST KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND FKEE KOMUNA E GLLOGOCIT KOMUNES OF GLLOVOCIT			
PRANUAR 08/04/2026			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	A2747	

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO FONDIT KOSOVES PER EFICIENCEN TE ENERGJISE KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EF. KASNOST KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE	
Nr.Br.No.	291/26
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	- 3 -
Data/Datumi/Date:	03.04.26
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

AMANDAMENT (I) I MARRËVESHJES

për bashkëfinancim në projektin për Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë Banesore Sociale II, në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Komunës së Gllogovcit (Drenasit).

Ky amendament bëhet me qëllim të ndryshimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit Nr. protokoli (FKEE) 2025/24 të datës 01.11.2024, e lidhur ndërmjet Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) dhe Komunës së (Gllogovcit) Drenasit, si vijon:

Palët:

1. **Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)**, përfaqësuar nga znj. Njomza Hoxha, në cilësinë e Drejtores Menaxhuese të FKEE-së.
2. **Komuna e Gllogovcit (Drenasit)** përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Gllogovcit (Drenasit).

Duke marrë parasysh:

- nevojën për të saktësuar vlerat përfundimtare të projektit referuar Marrëveshjes për Bashkëfinancim, si pasojë e ndryshimeve të konstatuara në vlerën fillestare të projektit, të cilat kanë rezultuar nga përfundimi i plotë i punimeve dhe nga rishikimi përfundimtar i investimit, në përputhje me kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e punëve;

Palët bien dakord për ndryshimet në vijim:

Neni 1

Ndryshohet pika 1.6.1, Neni 1, nga Marrëveshja e Bashkëfinancimit:

Shuma e bashkëfinancimit të projektit është 210,305.87 EUR (100%) nga të cilat:

- 189,275.28 EUR (90 %) financohet nga FKEE, dhe
- 21,030.59 EUR (10%) financohet nga Komuna.

Neni 2

Ndryshohet tabela tek Shtojca 4 nga Marrëveshja e Bashkëfinancimit: Kontratat midis FKEE dhe Kontraktorëve për Shërbime të ndryshme dhe Punime.

Nr.	Kontrata/Fushëveprimi	Kontraktori	Vlera	Vlera 10%
-----	-----------------------	-------------	-------	-----------

	Auditimi i Energjisë, modelet teknike, mbikqyrja, komisionimi dhe periudha e DLP	Studio Links 4	13,800.00	1,380.00
	Punët për zbatimin e MEE	G.O.E IOT Smart& Green Sh.P.K, UDHA Sh.P.K dhe Eleganca-Com Sh.P.K	196,505.87	19,650.59
	Totali		210,305.87	21,030.59

Neni 3

Ndryshohet tabela tek Shtojca 6 nga Marrëveshja e Bashkëfinancimit: Detajet lidhur me pagesën e pjesës së bashkëfinancimit nga Komuna, në vlerë 10% të vlerës së përgjithshme të projektit.

Nr	Projekti	Vlera totale e projektit	Vlera e financimit nga FKEE – 90%	Vlera prej 10% e bashkëfinancimit nga Komuna
1	Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë-Banësore Sociale -II- Gllogovc (Drenas)	210,305.87	189,275.28	21,030.59

Neni 4

Ekzekutimi i pagesës nga FKEE në llogarinë e Komunës

Vlera prej 51.89 Euro përfaqëson diferencën e vlerës së bashkëfinancimit prej 10% ndërmjet projektit fillestar dhe projektit të realizuar. Kjo shumë do t'i kthehet Komunës së Gllogovcit-Drenasit përmes llogarisë së Thesarit nr. 1000400070000180, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e nënshkrimit të këtij Amandamenti.

Kthimi i kësaj difference bëhet duke marrë parasysh se Komuna, në fillim të realizimit të projektit, ka kryer pagesën e plotë të obligimit prej 10% në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëfinancimit.

Neni 5

Ndikimi në dispozitat tjera

5.1. Ky amendament nuk ndryshon ndonjë dispozitë tjetër të marrëveshjes, përveç asaj që është specifikuar në këtë dokument.

5.2 Të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes mbeten në fuqi dhe janë të zbatueshme.

Neni 6

Fuqia ligjore e amendamentit

Ky amendament hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është pjesë integrale e Marrëveshjes për Bashkëfinancim në mes FKEE-së dhe Komunës së Glllogovcit (Drenasit).


Palët:

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë


Njomza Hoxha
Drejtoreshë Menaxhuese e FKEE-së



Komuna e Glllogovcit (Drenasit)


Ramiz Lladrovci
Kryetari i Komunës



Datë: 03 / 04 / 2016.